



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2026

VENDIM
Nr. 88, datë 18.02.2026

PËR
PËRFUNDIMIN PARA AFATIT TË TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM ME
PËLQIM PËR GJYQTAREN ZNJ. ARDIOLA ÇELA

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 46, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe bazuar në Vendimin të tij nr. 704, datë 17.10.2025, “Për transferimin e përkohshëm të gjyqtares znj. Ardiola Çela në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim, për gjyqtaren znj. Ardiola Çela.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datë 18.02.2026.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. Ardiola Çela, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR